



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
RRETHI GJYQËSOR TIRANË

Nr.Regj.Them. 14156/8248  
Data e regjistrimit 14.12.2020

Nr.Vendimi 1838  
Data e vendimit 26.03.2021

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

**GJYQTARE: Vjosa Zaimi**

Asistuar nga sekretare gjyqësore; **Rovena Vani**

sot në datë 26.03.2021 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket palëve:

**KËRKUES:** Blenard Gila, i biri i Ndue dhe Manushaqe, dtl.24.02.1984, lindur në Lezhë e banues në Tiranë, Rr. "Arben Broci", Kompleksi "Garden City", Nd. Ap. 4, H. Shk. B 9, Kashar, Mezez, Tiranë.

Adjola Gila, e bija e Ndue dhe Mrikë, dtl.01.06.1983, lindur në Lezhë e banues në Tiranë, Rr. "Arben Broci", Kompleksi "Garden City", Nd. Ap. 4, H. Shk. B 9, Kashar Mezez, Tiranë.

Perfaqësuar të dy palet kërkuese me prokurë të posaçme nr.1665 rep, nr.237 kol, date 24.03.2021, nga Av.Lira Kolasi me nr.license 8701 dhe nga Av.Jurgen Osmani me nr.license 10474.

me adrese komunikimi për të dy palet; Rr. "Abdyl Frasheri", Pall. 6, Ap. 5. Tiranë, tek Av.Lira Kolasi

Nr.cel; 069 41 15 533

E mail; [lira\\_kolasi@yahoo.com](mailto:lira_kolasi@yahoo.com)

**OBJEKTI:** Zgjidhje martesë me pelqim reciprok të të dy bashkeshortëve.

Miratimin e projekt marreveshjes nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020.

Miratimin e Amendim - Marreveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021

e hartuar para noteres Donika A. Gjini.

**BAZA LIGJORE:** Neni 73,125 e vijues të K.Familjes, neni 53 i Kushtetutës së RSH, K.Civil i RSH

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, pasi dëgjoi kërkesat të cilët kërkuan pranimin e kërkesës,



#### VËREN

Se para gjykatës është paraqitur padia me objekt: “Zgjidhje martesë me pelqim reciprok të të dy bashkeshortëve. Miratimin e projekt marrëveshjes nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020.Miratimin e Amendim - Marrëveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini”.

Në bazë të nenit 36 të K.Pr.Civile kjo çështje hyn në juridiksionin gjyqësor. Në bazë të nenit 349 të K.Pr.Civile gjykata ka kompetencën lëndore në shqyrtimin e kësaj çështje.

Neni 51 i K.Pr.Civile, parashikon se: “Paditë për vërtetimin e qenies ose mosqenies së martesës, për anulimin e martesës dhe për zgjidhjen e saj, mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku bashkeshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit ose në gjykatën ku ka banimin i padituri”.

Në rastin konkret, kjo gjykatë është kompetente, pasi është gjykata ku palët kanë vendbanimin e tyre të fundit të përbashkët.

Gjate gjykimit palet kerkuese kerkuan shtimin e objektit te kerkeses se tyre duke paraqitur per miratim para gjykates edhe Amendim - Marrëveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, ne te cilen kane shprehur vullnetin e tyre te ndryshuar lidhur me pasojat e zgjidhjes se marteses, persa i perket pjesetimit te pasurise.

Gjykata në baze të nenit 185 të K.Pr.Civile ka pranuar kërkesën për shtimin e objektit të kërkesës, sepse palet kerkuese kanë të drejtën të disponojnë mbi objektin e gjykimit dhe ishin të lidhura thelbesisht me objektin e gjykimit.

Në bazë të nenit 134 të K.Familjes, Gjykata bëri të gjitha përpjekjet e saj për pajtimin e palëve.

Gjykata krijoi bindjen se vullneti i palëve për zgjidhjen e martesës ishte real dhe i lirë dhe se nuk kishte asnjë mundësi pajtimi midis palëve, pasi marrëdhëniet e tyre ishin tronditur deri në atë masë sa e bënte të pamundur jetesën e tyre të përbashkët.

Në këto kushte gjykata mori në shqyrtim pretendimet e palëve në seancë gjyqësore, duke vlerësuar faktin dhe provat e paraqitura nga palët në krahasim me ligjin e aplikueshëm.

**Perfaqesuesit e paleve kerkuese parashtruan si me poshte; Palet kane lidhur martesë ligjore në datë 19.01.2005. Nga kjo martesë nuk kane femije.**

Fillimisht kane shkuar mire, por me pas kane lindur mosmarrëveshje. Kjo marrëdhënie nuk mund të vazhdojë pasi martesë e ka humbur qëllimin e saj.

Palet e kane vendosur që të bëjnë zgjidhjen e martesës me mirëkuptim përsa i përket pasojave të saj, edhe përsa i përket likuidimit të pasurisë bashkeshortore.

Palet kane vendosur edhe për mbiemrin që kerkuesja të marrë mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.

Ne i kemi paraqitur gjykatës këtë Projekt – Marrëveshje për miratim.

Pas seances e pajtimit ku është diskutuar në lidhje me kushtet e parashikuara në Projekt - Marrëveshjen e paleve, është konstatuar nga gjykata se pasuria e vene gjatë martesës në një apartament, është fituar me anë të kontratës së porosisë nr 391 rep 172 kol dt.28.01.2019 dhe nuk ishte ende e rregjistruar në ASHK. Në këto kushte gjykata ka orientuar palet se kjo pasuri nuk mund të ishte objekt i pjesëtimit të pasurisë, përse kohe ajo nuk është rregjistruar në pronësi të paleve.

Kështu që ne kemi vendosur që të bëjmë pjesëtimin e kësaj pasurie në një moment të dytë, pas zgjidhjes së martesës.

Po kështu, në lidhje me kontratat e kredisë të marre për likuidimin e këtij apartamenti, Kontratën e Kredisë të datës 21.02.2019 dhe Kontratën e Kredisë të datës 01.04.2019, kemi vendosur që të shprehemi në një moment të dytë, pas zgjidhjes së martesës.

Ne kemi vendosur që t'i nënshtrojmë pjesëtimit të pasurisë me marrëveshje vetëm për dy shoqëri; shoqëria "Cosmos Tours" shpk dhe shoqëria "Manu Travel" shpk

Meqenëse ato janë krijuar pas martesës kontributi është i përbashkët 50% secili. Me qëllim që të jete me lehtë për të dy palet, në ushtrimin aktivitetit në mënyrë të pavarur, ne kemi vendosur që 100% të kuotave tek shoqëria "Cosmos Tours" shpk të kalojnë në emrin e Adjola Gila (Lekgjonaj) dhe 100 % të kuotave tek shoqëria "Manu Travel" shpk të kalojnë në emër të Blenard Gila, duke kompensuar pjesët e secilit në shoqëri tjetër.

Në lidhje me shoqëri "Loveair" shpk kemi vendosur që nuk do të jete pjesë e pjesëtimit të pasurisë me këto marrëveshje.

Ne i kemi paraqitur gjykatës këtë Amendim të Projekt – Marrëveshje, në të cilin ne kemi pasqyruar ndryshimet përkatëse dhe kemi bërë shtimin e objektit të kërkesës.

Sa me sipër kërkojmë miratimin e Miratimit të Projekt - Marrëveshjes nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020, si dhe miratimin e Amendimit - Marrëveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini.

**I). Gjykata do të hetojë lidhur me vullnetin e palëve për zgjidhjen e martesës.**

**Gjykata cmon se për zgjidhjen e çështjes duhet t'i referohet dispozitave të mëposhtme:**

Neni 125 i K.Familjes parashikon: “Kur bashkëshortët bien dakort për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën, edhe një Projekt - Marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.”

Neni 127 i K.Familjes parashikon: “Gjykata vendos zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar.”

Neni 128 i K.Familjes parashikon: “Në rast se gjykata konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve, pezullon gjykimin për tre muaj dhe u kërkon bashkëshortëve të bëjnë rregullimet e duhura në marrëveshje. Në qoftë se edhe pas afatit të parashikuar më sipër nuk janë bërë rregullimet e duhura, gjykata refuzon miratimin dhe rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve”.

Gjatë gjykimit rezultoi e provuar se: Sipas çertifikatës së martesës, rezulton se **Blenard Gila dhe Adjola Gila** kanë lidhur martesë ligjore në datë 19.01.2005.

Palët deklarojnë se martesë e tyre e ka humbur qëllimin e saj, pasi e kanë ndërprerë jetën e përbashkët bashkëshortore.

Palët deklarojnë se jetesa e përbashkët është bërë e pamundur për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme midis tyre.

Palët kanë rënë dakort të zgjidhin martesën me pëlqim reciprok dhe të mos shprehen për fajësi.

**Gjykata cmon se grindjet e vazhdueshme i kanë tronditur marrëdhëniet midis palëve, duke sjellë humbjen reciproke të ndjenjave karshi njëri – tjetrit.**



Provohet se palët nuk bashkëjetojnë prej disa kohesh, duke shkelur detyrimin për jetë të përbashkët, e parashikuar nga neni 55 i K.Familjes.

Provohet se është shkelur një nga detyrimet që rrjedhin nga martesë për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës, parashikuar nga neni 50 i K.Familjes.

Gjykata, pasi shqyrtoi rrethanat e faktit të parashtruara nga palët, krijoi bindjen se vullneti i secilës palë për zgjidhjen e martesës është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok.

Nisur nga këto fakte, gjykata çmon se martesë e palëve ndërgjyqëse e ka humbur qëllimin e saj për të dy kërkuesat, prandaj kjo martesë duhet të zgjidhet.

**Gjykata çmon të miratojë Projekt - Marrëveshje nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, si dhe Amendim Marrëveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, përse i përket vullnetit të palëve për zgjidhjen e martesës.**

## **II. Gjykata do të hetojë lidhur me pasojat e zgjidhjes së martesës.**

### **A). Përse i përket mbiemrit.**

**Gjykata çmon se për zgjidhjen e çështjes duhet t'i referohet dispozitave të mëposhtme:**


Neni 146 i K.Familjes parashikon se: “Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës. Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës”.

Në rastin konkret, nga çertifikata e martesës të palëve ndërgjyqëse rezulton se kërkuesja Adjola Gila me lidhjen e martesës ka marrë mbiemrin e bashkëshortit.

**Përse i përket mbiemrit, palët kanë parashikuar në Projekt – Marrëveshje që; “Pas zgjidhjes së martesës, Znj. Adjola Gila do të marrë mbiemrin e vajzerise “Lekgjonaj”.**

**Gjykata çmon të Projekt - Marrëveshje nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, si dhe Amendim Marrëveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol**

date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, përsa i përket mbiemrit. Me zgjidhjen e martesës Adjola Gila do të marrë mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës “Lekgjonaj”



**B). Përsa i përket marrëdhënieve pasurore.**

**Gjykata çmon se për zgjidhjen e çështjes duhet t'i referohet dispozitave të mëposhtme:**

Neni 127 i K.Familjes parashikon: “Gjykata vendos zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore.”

**Përsa i përket marrëdhënieve pasurore**, palët në Projekt - Marrëveshje fillestare të paraqitur për miratim gjykates kanë parashikuar; “Me marrëveshje midis tyre, Subjektet bien dakord që kjo Projektmarrëveshje prodhon efektet juridike të parashikuara nga neni 73 e vijues i Kodit të Familjes.

Në këto kushte, me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që pasuria bashkëshortore, apartamenti i porositur me Kontratën e Porosisë nr. 391 Rep, nr172 Kol, datë 28.01.2019, t'i mbetet Z. Blenard Gila, në pjesë të plotë (100%). Në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Shitjes, Z. Blenard Gila bëhet pronar me pjesë të plotë (100%).

Z. Blenard Gila merr përsipër shlyerjen në vijim (pas nënshkrimit të kësaj projekt marrëveshje) të detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Kredisë të datës 21.02.2019 dhe në Kontratën e Kredisë të datës 01.04.2019, shuma të marra për likuidimin e këtij apartamenti.

Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë “Cosmos Tours” shpk, me numër NUIS L81407013H do t'i kalojë Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Adjola Gila, në shoqërinë “Loveair” shpk, me numër NUIS L91706025M, do t'i mbetet Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë “Manu Travel” shpk, me numër NUIS L97511504F, do t'i mbetet Z. Blenard Gila, me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

Gjate gjykimit kanë ndryshuar vullnetin e tyre ne lidhje me pjesetimin e pasurive te vena gjate martesës me Amendim Marreveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, ne te cilen parashikohet si me poshte;

Palet kanë kane depozituar Marreveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt – Marreveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim i Bashkesise Ligjore) Nr.5974 rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020 prane Gjykates se Shkalles së Pare Tirane.

**ATEHERE, sa me siper:**

Palet bien dakort te bejne ndryshimet e meposhtme ne Marreveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt - Marreveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim i Bashkesise Ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020:

**Neni 6 te behet:**

**NENI6**

**PJESTIMI I PASURIVE**

6.1 Me marrëveshje midis tyre, Subjektet bien dakord që kjo Projektmarrëveshje prodhon efektet juridike të parashikuara nga neni 73 e vijues i Kodit të Familjes.

6.2 Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë “Cosmos Tours” shpk, me numër NUIS L81407013H do t’i kalojë Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

6.3 Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë “Manu Travel” shpk, me numër NUIS L97511504F, do t’i mbetet Z. Blenard Gila, me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

Ky Ndryshim eshte pjese integrale e Marreveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt - Marreveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim i Bashkesise Ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020. Te gjitha Nenet dhe parashikimet e tjera do te ngelen te pandryshuara.

**Gjykata vlerëson nese parashikimet per pjesëtimin e pasurive jane ne përputhje me ligjin dhe nese i plotesojne intersat e te dy paleve.**

Meqenese te dy pasurite objekt i pjestimit ne kete Projekt marrëveshje midis paleve rezulton se jane vene gjate martesës, atehere ato jane objekt pjesëtimi sipas ligit.

Sipas ligjit prezumohet se bashkepronaret e ketyre dy pasurive jane bashkeshortet Adjola Gila dhe Blenard Gila, edhe pse mund te jene te rregjistruara vetem ne emer te njerit prej bashkeshorteve.

Sipas ligjit, pjeset takuese te bashkeshorteve bashkepronare jane 1/2 pjesë secili prej tyre.

Ne rastin konkret, palet kane vendosur qe secili prej tyre te mbaje ne pronesi te tij, nje prej shoqërive, duke kompesuar pjeset takuese te tyre.

**Sa me sipër, Gjykata cmon qe parashikimet e paleve per pjesëtimin e pasurive jane ne perputhje me ligjin dhe me interesat e te dy paleve.**

**Gjykata cmon të miratojë Projekt - Marrëveshje nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, si dhe Amendim Marreveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, përsa i përket marrëdhënieve pasurore si kane parashikuar palet.**

- Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, 100 % e Kuotave të shoqërisë “Cosmos Tours” shpk, me numër NUIS L81407013H do t’i kalojë Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ), me gjithë të drejtat dhe detyrimet.
- Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, 100 % e Kuotave të shoqërisë “Manu Travel” shpk, me numër NUIS L97511504F, do t’i mbetet Z. Blenard Gila, me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

**C). Përsa i përket ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.**

Nga çertifikata familjare e palëve rezulton se palët nuk kanë fëmijë. Sa më sipër gjykata cmon se pas zgjidhjes se martesës, nuk ka pasoja juridike të tjera për të zgjidhur.

**Gjykata përfundimisht çmon të miratojë Projekt - Marrëveshje nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020 e hartuar para noteres Donika A. Gjini dhe Amendim - Marreveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini, meqnese rezulton se nuk cenon interesat e asnje prej paleve.**

Projekt - Marrëveshje, si dhe Amendim te Projekt -Marreveshjes, nga momenti i miratimit nga Gjykata, bëhen pjesë e këtij vendimi dhe qëndrojnë bashkalidhur me të.

Në bazë nenit 143 të K.Familjes, një kopje e vendimit pasi ai të ketë marrë formë të prerë, dërgohet nga gjykata për regjistrim në Zyrën e Gjendjes Civile, Kashar, ku palët ndërgjyqëse kanë gjendjen civile dhe në bazë të ligjit “Për gjendjen civile”, kjo Zyrë detyrohet që të bëjë ndryshimet përkatëse në Rregjistrin e Gjendjes Civile, në përputhje me këtë vendim.



Shpenzimet gjyqesore ne masen 3.000 leke taksa e kerkeses mbeten sic jane kryer, shpenzime per njoftim nuk ka.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenëve 132, 133, 134, 135, 143, 144, 146/1 të Kodi i Familjes, 126, 310 të K.Pr.Civile:

### VENDOSI

- Pranimin e kerkeses;
- Zgjidhjen e martesës midis paleve Adjola Gila dhe Blenard Gila .
- Me zgjidhjen e martesës Adjola Gila do te marre mbiemrin qe ka patur para lidhjes se martesës "Lekgjonaj".
- Miratimin e Projekt - Marrëveshje nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020 e hartuar para noteres Donika A. Gjini dhe Amendim - Marreveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini.
- Projekt - Marrëveshje nr.5974 rep nr.905 kol dt.04.12.2020 e hartuar para noteres Donika A. Gjini dhe Amendim - Marreveshje Nr. 1666 rep dhe 238 kol date 24.03.2021 e hartuar para noteres Donika A. Gjini jane pjese perberese e ketij vendimi.
- Shpenzimet gjyqesore ne masen 3.000 leke taksa e kerkeses mbeten sic jane kryer, shpenzime per njoftim nuk ka.
- Nje kopje e ketij vendimi pasi te marre forme te prere i dergohet Zyres se Gjendjes Civile Kashar per te bere ndryshimet perkatese ne Rregjistrin e Gjendjes Civile.
- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim, ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

U shpall në Tiranë më 26.03.2021

SEKRETARE  
ROVENA VANI

GJYQTARE  
VJOSA ZAIMI

Nr	Shpenzime gjyqesore	Pala qe ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqesor				Sasi	Cmimi	Vlere
		Gjykata	Padites	I Paditur	P.trete			
1	Tarife Gjyqesore		3000			1	3000	3000
2	Shpenzime per deshmitar							0
3	Shpenzime per permbaruesit gjyqësor							0
4	Shpenzime per ekspert							

Vendimi mori formë të prerë pasi

nuk u ankimua më dt 12/05 2021

Tiranë më dt 14/05 2021

K / SEKRETARE

AURELA DOÇI



REPI  
GJYKAT  
TIRA

5	Shpenzime per psikolog/përkthyes							0
6	Shpenzime per këqyrje							0
7	Shpenzime noteriale							0
8	Shpenzime per njoftime							0
9	Shpenzime per fotokopje							0
10	Shperblim per avokat paditesi							0
11	Shperblim per avokat I padituri							0
12	Shperblim per avokat palet etj							0
13	Shpenzime te tjera							0
Shuma			3000					3000

1501  
1501



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER DONIKA A. GJINI**  
**ADRESA Rruga "Emin Duraku",**  
**P.Av.Vjeter, Nr.6**  
**TEL: 692070532**

# **MARRËVESHJE PËR ZGJIDHJE MARTESE ME MIRËKUPTIM**

**(AMENDIM)**

**Nr. repertori: 1666**

**Nr. koleksioni: 238**

**Tirane më 24/03/2021**

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

**\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë**



**A2021052970026987275**



A2021052970026987275

**NDRYSHIM**

**MARREVESHJE PER ZGJIDHJE MARTESE ME MIREKUPTIM**

*(Projekt – Marreveshje per zgjishje martese, likujdim i bashkesise ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, date 04.12.2020*

Sot me date 24 Mars 2021 (dymije e njezet e nje) te Merkure, para meje Noteres Donika Gjini, me seli ne adrese: Rr.Emin Duraku, Tirane, u paraqiten personalisht palet kontraktore te poshteshenuara:

**Znj. Adjola GILA**, atësia Ndue dhe mëmësia Mrikë, lindur në Manati Lezhë, më datë 01.06.1983 dhe banuese në Tiranë, Njësia Bashkiake Kashar, me adresë Rr."Arben Broci" Kompleksi Garden City; Nd. Ap.4; H. Shk.B9; Kashar; Mëzez; 1051; pajisur me Kartë Identiteti me numër personal I35601099S; dhe

**Z. Blenard GILA**, atësia Ndue dhe mëmësia Manushaqe, lindur në Lezhë, më datë 24.02.1984 dhe banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Kashar, me adresë Rr."Arben Broci" Kompleksi Garden City; Nd. Ap.4; H. Shk.B9; ; Kashar; Mëzez; 1051; pajisur me Kartë Identiteti me numër personal I40224199L.

(se bashku referuar ketu e me poshte si "Palet")

te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj amendim marreveshje, si me poshte:

**MEQENESE:**

A. Palet kane lidhur ndermjet tyre Marreveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt – Marreveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim I Bashkesise Ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020;

B. Ne perputhje me Nenin 6:

**NENI 6**

**PJESTIMI I PASURIVE**

6.1 Me marrëveshje midis tyre, Subjektet bien dakord që kjo Projektmarrëveshje prodhon efektet juridike të parashikuara nga neni 73 e vijues i Kodit të Familjes.

6.2 Në këto kushte, me nënshkrimin e kësaj projektmarreveshje, subjektet kanë rënë dakord që pasuria bashkëshortore, apartamenti i porositur me Kontratën e Porosisë nr. 391 Rep, nr. 172 Kol, datë 28.01.2019, t'i mbetet Z. Blenard Gila, në pjesë të plotë (100%). Në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Shitjes, Z. Blenard Gila bëhet pronar me pjesë të plotë (100%).

Z. Blenard Gila merr përsipër shlyerjen në vijim (pas nënshkrimit e kësaj projektmarreveshje) të detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Kredisë të datës 21.02.2019 dhe në Kontratën e Kredisë të datës 01.04.2019, shuma të marra për likuidimin e këtij apartamenti.

6.3 Me nënshkrimin e kësaj projektmarreveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë "Cosmos Tours" shpk, me numër NUIS L81407013H do t'i kalojë Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

6.4 Me nënshkrimin e kësaj projektmarreveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Adjola Gila, në shoqërinë "Loveair" shpk, me numër NUIS L91706025M, do t'i mbetet Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.





A2021052970026987275

6.5 Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë "Manu Travel" shpk, me numër NUIS L97511504F, do t'i mbetet Z. Blenard Gila, me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

C. Palet kanë karrë depozituar Marrëveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt – Marrëveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim I Bashkesise Ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020 prane Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

**ATEHERE, sa me sipër:**

Palet bien dakort te bejne ndryshimet e meposhtme ne Marrëveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt – Marrëveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim I Bashkesise Ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020:

**Neni 6 te behet:**

**NENI 6**

**PJESTIMI I PASURIVE**

- 6.1 Me marrëveshje midis tyre, Subjektet bien dakord që kjo Projekt marrëveshje prodhon efektet juridike të parashikuara nga neni 73 e vijues i Kodit të Familjes.
- 6.2 Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë "Cosmos Tours" shpk, me numër NUIS L81407013H do t'i kalojë Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.
- 6.3 Me nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshje, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë "Manu Travel" shpk, me numër NUIS L97511504F, do t'i mbetet Z. Blenard Gila, me gjithë të drejtat dhe detyrimet.

*Ky Ndryshim eshte pjese integrale e Marrëveshje Per Zgjidhje Martese Me Mirekuptim (Projekt – Marrëveshje Per Zgjidhje Martese, Likujdim I Bashkesise Ligjore) Nr.5974rep, Nr.905kol, Date 04.12.2020. Te gjitha Nenet dhe parashikimet e tjera do te ngelen te pandryshuara.*

Une noteri, pasi ua lexova me ze te larte permbajtjen e kesaj kontrate paleve, konstatova se ajo vinte ne perputhje me qellimin e tyre dhe, pasi ata e nenshkruan me vullnetin e tyre te plote e te lire ne pranine time 3 (tre) kopje origjinale me vlere te njejte, vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

**PALET**

**Adjola GILA (LEKGJONAJ)**

*Adjola Gila*

**Blenard GILA**

*BLENARD GILA*

**NOTERE**

**Donika A. GJINI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDËRE TIRANË

NOTER DONIKA A. GJINI  
ADRESA Rruga "Emin Duraku",  
P.Av.Vjeter, Nr.6  
TEL: 692070532

# MARRËVESHJE PËR ZGJIDHJE MARTESE ME MIRËKUPTIM

(PROJEKT MARRËVESHJE PËR ZGJIDHJE MARTESE, LIKUIDIMI I  
BASHKËSISË LIGJORE)

Nr. repertori: 5974

Nr. koleksioni: 905

Tirane më 04/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2020052970094153508



## **PROJEKT - MARRËVESHJE**

*(Për zgjidhje martesë/likuidimi i bashkësisë ligjore/pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore)*

Sot, më 04 Dhjetor 2020 (dymijë e njëzet), ditën e Premte, përpara meje Noteres Donika Gjini, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me seli në Tiranë, Rruga "Emin Duraku", u paraqitën personalisht subjektet:

**Znj. Adjola GILA**, atësia Ndue dhe mëmësia Mrikë, lindur në Manati Lezhë, më datë 01.06.1983 dhe banuese në Tiranë, Njësia Bashkiake Kashar, me adresë Rr."Arben Broci" Kompleksi Garden City; Nd. Ap.4; H. Shk.B9; Kashar; Mëzeq; 1051; pajisur me Kartë Identiteti me numër personal I35601099S; dhe

**Z. Blenard GILA**, atësia Ndue dhe mëmësia Manushaqe, lindur në Lezhë, më datë 24.02.1984 dhe banues në Tiranë, Njësia Bashkiake Kashar, me adresë Rr."Arben Broci" Kompleksi Garden City; Nd. Ap.4; H. Shk.B9; ; Kashar; Mëzeq; 1051; pajisur me Kartë Identiteti me numër personal I40224199L.

### **TË DHËNA PARAPRAKE**

Të lartpërmendurit deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre personale se kanë lidhur martesë më datë 19.01.2005 Zyra e Gjendjes Civile, arkiva Kolsh, gjë që vërtetohet nga Certifikata e Martesës me nr. 015373832, datë 05.10.2020.

Të lartpërmendurit deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre personale se nga kjo martesë nuk kanë patur fëmijë.

Të lartpërmendurit, sipas legjislacionit shqiptar janë në regjimin e bashkësisë ligjore, i cili do të likuidohet me miratimin e Projekt-Marrëveshjes.

### **Rezulton se deklaruesit, posedojnë si pasuri të përfutur gjatë martesës:**

1. Një apartament me sipërfaqe 135.6 m<sup>2</sup>, i parregjistruar në ASHK, i përfutur sipas Kontratës së Porosisë nr. 391 Rep, nr. 172 Kol, datë 28.02.2019, të notere Znj. Mimoza Sadushi, me palë porositëse Z. Blenard Gila dhe të Porositur shoqërinë "Park Construction Albania" shpk.
2. Kuotë në shoqërinë "Cosmos Tours" shpk, me numër NUIS L81407013H, themeluar në datën 05/02/2018, me zotërues 100 % të kuotës nga Z. Blenard Gila, me adresë: "Njësia Bashkiake nr. 10, rruga e Durrësit, pallati 102, kati i parë".
3. Kuotë në shoqërinë "Loveair" shpk, me numër NUIS L91706025M, themeluar në datën 03/05/2019, me zotërues 100 % të kuotës nga Znj. Adjola Gila, me adresë: "Rruga e Durrësit, sipër Kafe Flora, Pallati Nr.7, Ap Nr.2, kati i dytë.



4. Kuotë në shoqërinë “Manu Travel” shpk, me numër NUIS L97511504F, themeluar në datën 07/01/2019, me zotërues 100 % të kuotës nga Z. Blenard Gila me adresë “Lagjia Besëlidhja, Rruga Kosova, përballë Drejtorisë së Policisë, Godina Nr.7/12, Kati i parë”

**Rezulton se deklaruesit kanë detyrime ndaj të tretëve:**

1. Kontratë Kredie Bankare datë 21.02.2019, me palë Kredimarrëse Z. Blenard Gila, Znj. Adjola Gila dhe palë Kredidhënëse Intesa Sanpaolo Bank Albania” shpk, në shumën 14.800.000 (katërbëdhjet milion e tetëqindë mijë) lekë.
2. Kontratë Kredie Bankare Konsumatore datë 1.04.2019, me palë Kredimarrëse Z. Blenard Gila, Znj. Adjola Gila dhe palë Kredidhënëse Intesa Sanpaolo Bank Albania” shpk, në shumën 2.200.000 (dy milion e dyqindë mijë) lekë.

Raporti martesor, dikur reciprokisht i kënaqshëm, tashmë për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme, është bërë i pamundur vazhdimi i bashkëjetesës.

Sa më sipër, bashkëshortët në bazë të Nenit 125 e vijues të Kodit të Familjes, dhe Nenit 39, germa “h” të Ligjit 110/2018 “Për Noterinë” bien dakord të lidhin këtë aktmarrëveshje për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave përkatëse, me përmbajtjen si vijon:

**NENI 1**

**PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**

- 1.1 *Subjektet*, pasi kanë biseduar e rënë dakord midis tyre, deklarojnë dhe kërkojnë që me anë të kësaj projekt marrëveshje të përcaktojnë dhe rregullojnë, me pëlqimin reciprok:
  - zgjidhjen e martesës;
  - likuidimin e bashkësisë ligjore dhe pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore;
- 1.2 *Subjektet* deklarojnë dhe garantojnë se nëpërmjet kësaj projekt marrëveshje, kërkojnë me vullnetin e tyre të lirë e të plotë të përcaktojnë rregullimin e marrëdhënieve sociale e pasurore, si dhe pasojat që sjell zgjidhja e martesës.

**NENI 2**

**BAZA LIGJORE**

- 2.1 Baza Ligjore e Projekt marrëveshjes është:
  - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 53 i tij.
  - Kodi i Familjes (neni 125, 155, 158, 161, 96, 125, 126 e vijues i tij);
  - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
  - Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
  - Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar;





A2020052970094153508

### NENI 3

#### ZGJIDHJA E MARTESËS

- 3.1 Subjektet deklarojnë se me anë të kësaj *Projektmarrëveshje*, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, me mirëkuptim midis tyre të zgjidhin martesën e tyre ligjore e faktike.
- 3.2 Subjektet deklarojnë se arsyeja e zgjidhjes së martesës së tyre ka ardhur për shkak se martesë e ka humbur qëllimin për të cilin është lidhur, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme.
- 3.4 Palët deklarojnë se janë dakord ta zgjidhin martesën ligjore me pëlqim reciprok dhe pa fajin e asnjërit dhe nuk duan kontribut kompensues nga njëri tjetri.

### NENI 4

#### NDRYSHIMI I MBIEMRIT

- 4.1 Pas zgjidhjes së martesës Znj. Adjola GILA do të marrë mbiemrin e vajzërisë LEKGJONAJ.

### NENI 5

#### LIKUJDIMI I BASHKËSISË LIGJORE

- 5.1 Bashkëshortët në momentin e lidhjes së martesës, si dhe gjatë konsumimit të martesës ligjore, nuk kanë lidhur kontratë për të rregulluar regjimin pasuror martesor. Për këtë arsye, ata ndodhen nën regjimin e bashkësisë ligjore.
- 5.2 Subjektet deklarojnë se gjatë martesës kanë kontribuar për të vendosur pasuri të paluajshme, pasuri të cilat kërkojnë ti pjesëtojnë në vullnet të lirë e të plotë midis tyre.

### NENI 6

#### PJESTIMI I PASURIVE

- 6.1 Me marrëveshje midis tyre, Subjektet bien dakord që kjo *Projektmarrëveshje* prodhon efektet juridike të parashikuara nga neni 73 e vijues i Kodit të Familjes.
- 6.2 Në këto kushte, me nënshkrimin e kësaj *projektmarrëveshje*, subjektet kanë rënë dakord që pasuria bashkëshortore, apartamenti i porositur me Kontratën e Porosisë nr. 391 Rep, nr. 172 Kol, datë 28.01.2019, t'i mbetet Z. Blenard Gila, në pjesë të plotë (100%). Në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Shitjes, Z. Blenard Gila bëhet pronar me pjesë të plotë (100%).  
Z. Blenard Gila merr përsipër shlyerjen në vijim (pas nënshkrimit të kësaj *projektmarrëveshje*) të detyrimeve të përcaktuara në Kontratën e Kredisë të datës 21.02.2019 dhe në Kontratën e Kredisë të datës 01.04.2019, shumën të marra për likuidimin e këtij apartamenti.
- 6.3 Me nënshkrimin e kësaj *projektmarrëveshje*, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë "Cosmos Tours" shpk, me numër NUIS L81407013H do t'i kalojë Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.
- 6.4 Me nënshkrimin e kësaj *projektmarrëveshje*, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Adjola Gila, në shoqërinë "Loveair" shpk, me numër NUIS L91706025M, do t'i mbetet Znj. Adjola Gila (LEKGJONAJ) me gjithë të drejtat dhe detyrimet.
- 6.5 Me nënshkrimin e kësaj *projektmarrëveshje*, subjektet kanë rënë dakord që 100 % e Kuotës me zotërues Z. Blenard Gila, në shoqërinë "Manu Travel" shpk, me numër NUIS L97511504F, do t'i mbetet Z. Blenard Gila, me gjithë të drejtat dhe detyrimet.



A2020852970094153508

#### NENI 7

### INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

- 7.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë *Projekt marrëveshje*.

#### NENI 8

### LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 8.1 Kjo *Projekt marrëveshje*, është redaktuar në bazë të legjislacionit Shqiptar dhe konkretisht të Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë neni 73 e vijues të tij. Për sa i përket çështjeve që kjo *Projekt marrëveshje* nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.
- 8.2 Për sa më sipër, palët deklarojnë se vullneti i tyre është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin për pasojat e zgjidhjes së martesës.
- 8.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj *projekt marrëveshje* midis subjekteve kontraktuese, do të zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis tyre në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 8.4 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, për çështje që nuk bien dakord, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

#### NENI 9

### GJUHA E REDAKTIMIT TË PROJEKTMARRËVESHJES

- 9.1 *Projekt marrëveshja* u redaktua në gjuhën shqipe prej meje Noteres në 5 (*pesë*) ekzemplarë, e përbërë nga 5 (*pesë*) fletë secila, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëri ekzemplar vendoset në arkivën noteriale, një ekzemplar depozitohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dy ekzemplarë të tjerë u vihen në dispozicion respektivisht subjekteve të *projekt marrëveshjes*.

#### NENI 10

### HYRJA NË FUQI

- 10.1 Kjo *Projekt marrëveshje* hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit të subjektive të *projekt marrëveshjes* në prani të Noterit, nënshkrimit të saj nga Noteri dhe regjistrimit të *projekt marrëveshjes* me nr. \_\_ rep., dhe nr. \_\_ kol. në regjistrin Noterial.
- 10.2 Kjo *Projekt marrëveshje* do të marrë fuqi juridike dhe do të vihet në zbatim, pasi të pranohet dhe miratohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas procedurës përkatëse.

#### NENI 11

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 15.1 *Projekt marrëveshja*, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të subjekteve të *projekt marrëveshjes*, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.



A2020052970094151908

- 15.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 39 dhe 51 të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", me ndryshimet; vërtetoj nënshkrimin e tyre.
- 15.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Projekt marrëveshje, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Shpenzimet e kësaj Projekt marrëveshje do të paguhen nga të dy bashkëshortët në pjesë të barabarta.

I bashkëngjiten kësaj Projekt marrëveshje:

- 1) Çertifikatë Martese Nr. 015373832, datë 05.10.2020;
- 2) Çertifikatë e Gjendjes Familjare datë 16.10.2020;
- 3) Kontratë porosie/sipërmarrje për pasurinë e paluajshme;
- 4) Kontratë kredi bankare për pasurinë e paluajshme e datës 21.02.2019;
- 5) Kontratë kredi bankare për pasurinë e paluajshme e datës 01.04.2019;
- 6) Ekstrakt historik për shoqërinë "Cosmos Tours" shpk
- 7) Ekstrakt historik për shoqërinë "Loveair" shpk
- 8) Ekstrakt historik për "Manu Travel" shpk
- 9) Letërnjoftimet e Adjola Gila dhe Blenard Gila.

**SUBJEKTET:**

Adjola GILA (LEKGJONAJ)


*Adjola Gila*

Blenard GILA

*BLENAIRD GILA*

NOTERE

Donika A.C. HINI



**RAIFFEISEN BANK SHA**  
**DIVIZIONI I MENAXHIMIT TE RISKUT DHE KREDIVE**

Nr. 16218 Prot.

Tiranë, më 16/07 /2021

**Drejtuar:** Shoqerise "Cosmos Tours" Shpk  
Selia: Tirane Njësia Bashkiake nr. 10, rruga e Durrësit, pallati 102, kati i parë

**QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT**  
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

**Lenda:** Per regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me Numer Vendimi 1838 , Date Vendimi 26.03.2021 lidhur me Kalimin e Kuotave te Shoqerise Cosmos Tours shpk me numer NUIS L81407013H

Te nderuar,

Bazuar ne Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me Numer Vendimi 1838 , Date Vendimi 26.03.2021 lidhur me Kalimin e Kuotave te Shoqerise Cosmos Tours shpk me numer NUIS L81407013H jemi vene ne dijeni qe 100% te kuotave te Shoqerise Cosmos Tours shpk do te kalojne nga Z.Blenard Gila tek Znj. Adjola Gila (Lekgjonaj) me te gjithë te drejtat dhe detyrimet. Kalimi i pronesisë duhet te behet duke mbajtur ne fuqi dhe te regjistruar ne favor te RAIFFEISEN BANK SHA barren mbi kuotat e kapitalit te Shoqerise, barre e cila do te vazhdoje te qendroje e regjistruar ne regjistrin tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) dhe do te mbartet/pasqyrohet ne ekstraktin e gjendjes historike edhe pasi te behet kalimi i kuotave te kapitalit tek tek Znj. Adjola Gila (Lekgjonaj) sipas te gjitha Marreveshjeve Siguruese te nenshkruara me Banken deri ne shlyerjen totale te detyrimeve qe Shoqerite "GLOBUS-TRAVEL" Shpk dhe Cosmos Tours shpk kane ndaj RAIFFEISEN BANK SHA.

Me respekt,

**RAIFFEISEN BANK SHA**  
Perfaqesuar nga

Gledisa BUXHUKU






**COSMOS TOURS SHPK**

**NIPT: L81407013H**

**Tirane**

**Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane**

**VENDIM**

**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

Asambleja e Ortakeve, e perbere nga ortaku i vetem i kompanise Adjola Lekgjonaj u mbledh sot me dt. 23  
Korrik 2021, ne seline e shoqerise "Cosmos Tours" Shpk dhe vendosi si me poshte:

1. Heqjen e Admonistratorit Blenard Gila me nr ID I40224199L.
2. Emerimin Administrator Adjola Lekgjonaj me nr ID I35601099S

**ORTAKU I VETIM I SHOQERISE**

**Adjola Lekgjonaj**

*Adjole Lekgjonaj*



*23.07.2021*